



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 20761/prot.

2

Tiranë, më 30.122022

VENDIM

Nr. 57, datë 30.12.2022

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 38, DATË 08.06.2021 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË “PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE DHE RREGULLAVE TË VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE TË INSPEKTORËVE””

Në zbatim të nenit 212, pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në kuadër të nisjes së procedurave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve, nisur nga fakti se për periudhën e parë të vlerësimit, inspektorët në detyrë plotësojnë afatin 2-vjeçar në mars të vitit 2023, të parashikuar në nenin 16, pika 2, të vendimit nr. 38 datë 08.06.2021 “Për miratimin e procedurave dhe rregullave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve”, përjashtimisht për vlerësimin e parë, nga momenti i mbledhjes së dokumentacionit deri në momentin e miratimit të raportit përfundimtar të vlerësimit nga Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, afatet e vlerësimit do të shtyhen me tre muaj duke filluar në muajin prill të vitit 2023.

Për këto arsye,

VENDOSA:

1. Pas pikës 3 të nenit 44, të vendimit nr. 38, datë 08.06.2021 “Për miratimin e procedurave dhe rregullave të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve”, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Përjashtimisht, për periudhën e parë të vlerësimit, afatet procedurale të vlerësimit të etikës dhe veprimtarisë profesionale të inspektorëve, nga momenti i mbledhjes së dokumentacionit deri në momentin e miratimit të raportit përfundimtar të vlerësimit nga Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve, do të fillojnë në muajin prill të vitit 2023.”

2. Ngarkohen anëtarët e Komisionit të Emërimit dhe Vlerësimit të Inspektorëve dhe Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

